

Shën Pali - Apostull i identitetit të krishterë (Me rastin e vitit të Shën Palit - qershor 2008-qershor 2009)

Të nderuar të pranishëm,

Ngjarje të shumta me përmbajtje fetaro-kulturore, po edhe shkencore, të cilat po shënohen këtë vit, disi nuk bëhen pa u ndërlidhur edhe me një argument tjetër, siç është kremtimi i vitit jubilar, kushtuar Shën Palit, Apostull. Prandaj, është mirë që edhe në këtë simpozium ndërkombëtar, kushtuar Imzot Lazër Mjedës, argjipeshkvi që la gjurmë të pashlyeshme në historinë tonë, na jepet rasti të flasim për Shën Palin – shenjt dhe martir, predikues, përhapës dhe dëshmitar i palodhshëm i Ungjillit.

E gjithë bota e krishterë, sidomos gjatë këtij viti, po i kushton rëndësi të madhe jetës dhe veprës së këtij shenjt, i cili pa dyshim ishte dhe mbeti frymëzues i madh për studiues të shumtë, aq më tepër për njerëz të kushtuar Zotit, siç ishte argjipeshkvi Mjeda.

Në këtë kontekst, kaloi gati një dekadë që kur Kisha Katolike e gjithëmbarshe si dhe ajo ndër shqiptarë, kremtoi 2000 vjetorin e Krishterimit, ndërsa nga qershori i vitit të kaluar e deri në qershor të këtij viti, Kisha po kremton 2000 vjetorin e lindjes së Shën Palit Apostull, vit jubilar ky, të cilin e shpalli Ati i Shenjtë, Papa Benedikti XVI.

Është një rast i mirë për të gjithë ne që më thellësisht ta studiojmë jetën e tij, veprën dhe porosinë e tij, dhe kështu, më për së afërmi, ta përjetojmë mësimin e tij të cilin na la në letrat e shumta.

Lidhur me jetën, veprimtarinë dhe me ungjillëzimin e popujve, ndër ta edhe të popullit shqiptar nga ky Shenjt i madh, është folur dhe shkruar shumë. Mirëpo, kjo temë, me këtë rast, ka për qëllim ta begatojë sado pak këtë simpozium, veçmas duke promovuar vitin jubilar kushtuar Shën Palit.

Periodha e jetës së Shën Palit, është e karakterizuar jo vetëm me fillimin e përhapjes së një besimi të ri, por edhe të një civilizimi të madh të shumë popujve. Në këtë kontekst, edhe ne si popull, e patëm fatin të njihemi me këtë besim dhe rend të ri shoqëror, të cilin kishte filluar ta predikojë Shën Pali.

Lidhur me këtë, mund të marrim si shembull kur Pali u drejtohet qytetarëve të Athinës, e kjo do të mund të vlente edhe për ilirët, duke u thënë: *“Po shoh se në çdo pikëpamje qenkeni njerëz shumë besimtarë. Sepse, duke kaluar e vërejtur monumentet tuaja të kultit hyjnor, gjeta edhe një lter, në të cilin është shkruar: “Hyjit të panjohur.” Pra, Atë, të cilin ju e nderoni pa e njohur, unë jua kumtoj”*. (Vap 17, 22-23). Ky “Hyj i panjohur” për të cilin tani e tutje do të jetojë ky apostull, është Jezu Krishti, e Vërteta e amshuar.

Vendlindja e Saulit

Në Azinë e Vogël ndodhet vendi që dikur quhej Cilici dhe për kryeqytet kishte Tarsin. Ky qytet i njohur për tregti, ishte vend i shumë popujve të ndryshëm, prandaj për shkak të kësaj rëndësie, në vitin 66 para Krishtit, pushtohet nga Romakët dhe caktohet kryeqytet i krahinës së Cilicisë, ndërsa nga viti 1078 i takon Turqisë. Sot, në Tars ka mbetur vetëm hija e asaj madhështie që kishte dikur; mirëpo, sikur edhe të ishte zhdukur krejtësisht nga faqja e dheut

si shumë qytete tjera, emri i tij do të përmendej për jetë e mot, sepse rreth vitit, 5 në këtë qytet lindi¹ Shën Pali - Apostulli i identitetit të krishterë.²

Në Shkrimet e BV mësojmë se patriarku i popullit hebre, Jakobi kishte dymbëdhjetë djem, dhe më i riu prej tyre ishte Benjamini. Nga fisi i tij vijnë edhe prindërit e Shën Palit, të cilët si shumë hebregj të tjerë, për shkak të tregtisë, nga Palestina shpërngulen në Tars.

Emri i tij në veprat e apostujve, 9 herë përmendet si Saul dhe buron nga fjala hebregje *sha-al* që domethënë *kërkoj, lus*; ai që e kërkon Zotin dhe ai që i lutet Zotit, si emri i mbretit Saul (shekulli 11 para Krishtit). Pali, për vete e përdor emërtimin Pal – *Paulus* në tekstet burimore greke që domethënë *i vogël*.³

Formimi i tij

Vendi ku Sauli mori edukimin dhe formimin intelektual ishte i ndikuar nga kultura, gjuha, mësimet dhe mënyra e të jetuarit grek (*polis hellenis*). Por, edhe më i rëndësishëm është formimi i tij i ndikuar nga lidhja e gjakut, që do të thotë prejardhja hebregje dhe formimi i tij në frymën e mësimëve të Besëlidhjes së Vjetër.

Sipas traditës së vjetër rabinike, çdo hebre, si pesëvjeçar, duhej të fillojë ta lexojë *Torën* (Ligjin); si dhjetëvjeçar *Mishnën* (traditën gojore), ndërsa më vonë studimin e *Talmudit* (Mësimet hebregje).

Teologët e atëhershëm të Jerusalemit ishin të ndarë në dy grupe. Grupit të parë i printe njeriu paqësor *Hilel* që ishte më tolerant në shtjellimin e ngurtësisë së Ligjeve, ndërsa pjesën tjetër e udhëhiqte një mësues më fanatik që quhej *Shamaj*. Gamalieli ishte nipi i Hilelit dhe denjësisht do ta zëvendësojë më vonë. Kështu, Sauli do ta ketë fatin të jetë nxënës i Gamalielit. Te Sauli do të përplotësohen vazhdimisht dy argumente, që do të ndikojnë në formimin e tij: edukimi fetar dhe mësimi grek në Tars. Kësaj do t'i shtohet arsimimi biblik, pa të cilin do të ishte vështirë t'i kuptojmë Letrat paliane.⁴

Ai, pasi i kishte pranuar mësimet rabinike nga Gamalieli (khs. Vap 22, 3), ishte pjesëmarrës i rregullt në kremtime hebraike në Tempullin e Jerusalemit. Çmonte shumë sinagogat, pushimin e së shtunës, agjërimin, lutjet e përditshme të psalmeve, kushtimet e ndryshme, traditën e etërve, njohjen e Tora-s. Veçmas, Shkrimet Shenjt i kushton vëmendje të madhe, duke e mësuar përmendësh greqisht dhe hebraisht. Mbi të gjitha, ky përkushtim i madh ndaj shkrimeve të shenjta dhe traditës së etërve të vet, do të jetë shkas që Sauli të mos lejojë në asnjë mënyrë dhe nga askush të tronditet bota dhe besimi hebre. Prandaj, Sauli nuk do të zgjedhë forma për të “*mbrojtur rendin shoqëror*” dhe besimin e vet, por do të fillojë pamëshirshëm të persekutojë dhe të arrestojë të krishterët e parë.

Sauli salvon Kishën

¹ Data e saktë e lindjes së Shën Palit nuk dihet, por kur në vitin 34 vritet me gurë Shën Shtjefni, Shën Pali kishte kaluar të tridhjetat. Në vitin 63 i shkruan mikut të vet, Filemonit, se është plakur, dhe kjo merret si argument se i kishte kaluar të 60-at. Ndërsa, Shën Gjon Gojarti shkruan se Pali kishte 68 vjet kur pëson martirizimin në vitin 67. Kjo na dëshmon se për datën e saktë të lindjes së tij nuk mund të flitet, por afërsisht në vitet kur lindi edhe Shëlbuesi ynë, Jezu Krishti. Pali ose Sauli i Tarsit, sipas disa autorëve tjerë, ka lindur në vitin 8 pas Krishtit dhe është martirizuar në Romë në vitin 67 pas Krishtit gjatë përndjekjeve të Neronit. Krh. RUDOLF VIMER, *Život Svetoga Pavla*, UPT, Đakovo 2005, fq. 11-12.

² Letra pastorale, me të cilën ipeshkvijnjtë katolikë të Turqisë u drejtohen besimtarëve të tyre si përgatitje për vitin palian mban titullin: “*Dëshmitar dhe apostull i identitetit të krishterë*”. Festa e kthimit të Shën Palit, 25 janar 2008.

³ Lidhur me këtë emërtim, përshtatet edhe thënia e tij të cilën e pohon më tepër në kontekstin e përndjekjes së të krishterëve kur thotë: “*E në të vërtetë, unë jam më i vogli ndër apostuj...*” (1 Kor 15, 9).

⁴ Formimin intelektual të Saulit dhe ndikimin që kishte nga filozofia greke dhe tradita hebregje e përshkruan shumë bukur një ndër biografët më të shquar të Shën Palit, JOSEF HOLZNER. Mbi këtë shih veprën e tij: *Pavao*, Verbum, Split 2008, fq. 9-27.

Nga burimet e ndryshme biblike mësojmë edhe këto të dhëna: ishte hebre me nënshtetësi romake, përndjekës i krishterimit dhe gjatë një udhëtimi për t'i kapur të krishterët në Damask, iu dëftua Jezusi i ringjallur dhe e ftoi për një mision apo dërgim të ri, përkatësisht të jetë nxënës i tij.

Pali, jetën e vet e ndanë në dy pjesë: *Jeta pa Krishtin dhe koha në Krishtin*.

Ai e kuptoi se ishte në rrugë të gabuar, të cilën nuk do të duhej ta vazhdonte. Prandaj, kthimin dhe gjithë misionin e vet Pali do ta fuqizojë edhe me gjakun e derdhur si dëshmi e dashurisë ndaj atij që i shërbente.

Lidhur me karakteristikat e personalitetit të Palit, shkruan mons. Ghidelli: *“Më duket se ato mund t'i përmbledhim kështu: para së gjithash, ai ishte një person jashtëzakonisht i vendosur. Vetëm një person sikurse ai mund t'i bënte ballë përplasjes së pësuar në Damask, ku njerëzimi i tij u vu në një provë të fortë. Por këtu del në pah edhe ndershmëria e tij e madhe; për të kishte rëndësi të vihej në shërbim të së vërtetës dhe tani, pasi e ka zbuluar, e ndien për detyrë të ndërrojë rrugë: kjo është një ndershmëri që s'e luan topi”*.

Sauli, që u bë Pal, me siguri nuk ka ndryshuar temperament apo karakter, por, me ndihmën e hirit, karakterin e vet, me gjitha energjitë e veta fizike e shpirtërore, do ta orientojë drejt një pikësnyimi të ri: të fitojë Krishtin pasi është fituar prej Krishtit (khs. Fil 3,8). Këtu qëndron i tërë sekreti i lumturisë për çdo qenie njerëzore: të kërkojë e mundësisht të gjejë një qendër njësimi rreth së cilës do të sillej jeta e tij.⁵

Sauli dhe Shtjefni

Me kryqëzimin e Jezusit, hebrenjtë menduan se i kanë shpërndarë edhe nxënësit e tij dhe të gjithë ata që i besonin. Mirëpo, dita e pesëdhjetë pas Ngjalljes së Jezu Krishtit, dëshmon të kundërtën: Atë ditë pagëzohen rreth 3000 hebrenj.⁶ Në këtë kohë Sauli kthehet në Jerusalem, dhe këtu mëson se është përhapur një besim i ri në të cilin predikohet se Mesia ka ardhur. Sauli që kishte studiuar mirë shkrimet dhe ligjet hebreje, ishte i bindur se Mesia do të jetë një mbret dhe njeri i fuqishëm, i cili do ta lirojë popullin hebre nga pushtimi romak. Prandaj do të vihet në luftimin e kësaj bashkësie të re fetare, njerëzve që kishin filluar të quhen të krishterë. Këtë besim të ri nuk e përhapnin vetëm apostujt, tani këtë mision e kishin marrë edhe ndihmësit e tyre, xhakonët. Një ndër ta ishte Shtjefni. Në fakt, të krishterët e parë duheshin ashtu që gjithçka që kishin e ndanin mes veti dhe në këtë detyrë humane apostujt do të ndihmohen pikërisht prej xhakonëve, të cilët shugurohen nga apostujt, dhe u besohet kjo detyrë pasi që ishin burra në zë të mirë.

Shtjefni dallohet edhe për nga predikimet e veta, duke marrë para sysh se ai diskuton edhe me Saulin lidhur me Mesinë. Sauli ishte i bindur se *“është i mallkuar prej Zotit ai që dënohet me kryqëzim”*; ndërsa Shtjefni, bazuar në shkrimet e profetëve, mbron tezën se Mesia duhet të pësojë dhe të vdesë edhe ai si i Zgjedhuri i Hyjit. Këtu fillon kundërshtimi i rreptë mes tyre dhe, gjatë diskutimeve të mëtutjeshme, Shtjefni do të sulmojë edhe mësimin hebre mbi Ligjet dhe Sinagogën (Tempulli hebre) dhe dëshmia e tij për Mesinë do t'i kushtojë me kokë. Dëshmitar i këtij dënimi ishte edhe Sauli.⁷ Mësuesit e Ligjit hebre, sipas mësimave të tyre, ishin të vendosur të dënojnë dhe vrasin me gurë të gjithë ata që mësojnë ndryshe nga ajo që mëson Tora.

Shtjefni xhakon, i bindur në mësimin e Krishtit, në momentet e fundit të jetës së vet, do të vazhdojë të lutet për vrastarët me fjalët: *“O Zot, mos ua merr këtë për mëkat!”*⁸ dhe vdes duke

⁵ Shih. CARLO GHIDELLI, *Një vit me Shën Palin*, Kap. I Parë “Personaliteti i Saulit – Palit, Drita, Prizren 2009, fq. 12-16, këtu, fq. 13.

⁶ VaP 2, 41.

⁷ “I dënuari duhet të vritet vetëm me dëshmimin e dy ose tre dëshmitarëve: të mos vritet askush në bazë të dëshmimit të një njeriu të vetëm. Dora e dëshmitarëve duhet të ngrihet e para për ta vrarë dhe pas tyre le të ngrihet dora e mbarë popullit. Kështu do ta çrrënjosësh të keqen prej mesit tënd” Krh. Lp 17, 6-7.

⁸ Dhe ndërsa po e mbytnin me gurë, Shtjefni lutej e thoshte: “O Jezus Zot, merre shpirtin tim!” Atëherë ra në gjunjë dhe bërtiti me zë të madh: “O Zot, mos ua merr këtë për mëkat!” Posa i tha këto fjalë, ndërroi jetë” Krh. VaP 7, 59-60.

u bërë martiri i parë i krishterimit. Edhe veprat e apostujve dëshmojnë për faktin se Sauli e dha pëlqimin e vet për vrasjen e Shën Shtjefnit (Vap 8,1).

Vdekja e tij është çmimi që e pagoi Kisha e parë për t'u liruar nga nacionalizmi hebre dhe të fillojë të zbatojë në vepër misionin apo dërgimin e saj. Gjaku i Shën Shtjefnit në të njëjtën kohë ishte çmimi që e pagoi Kisha për apostullin e vet më të madh, i cili da ta shënojë këtë periudhë me predikimin e Lajmit të Gëzueshëm. “*Non sine sanguine – pa derdhje gjaku nuk ka falje*”!⁹ Shën Shjefni vdes, por nuk vdes e vërteta që ai predikoi, sepse pas kësaj të vërtete qëndron vet Zoti. Shën Augustini me të drejtë thotë: “*Si martyr Stephanus non sic orasset, Ecclesia Paulum non haberet*”! Mos të ishte lutja e Shtjefnit, Kisha nuk do ta kishte Palin”!¹⁰

Kthimi i Saulit

Damasku ishte qytet i dalluar për tregti dhe vend ku banonin njerëz të gjuhëve dhe kulturave të ndryshme. Drejt këtij qyteti Sauli niset me qëllim që të arrestojë të krishterët që ndodheshin aty. Pak para se të hyjë në qytet, Saulit i dëftohet Jezusi duke kërkuar prej tij llogari: “*Saul, Saul, pse po më salvon?*”¹¹ Dhe, që nga ky takim i Saulit me të Ringjallurin, pastaj pas pagëzimit në Damask nga një hebre i devotshëm me emrin Anani, ai do të ndryshojë jetën e vet duke u bërë nxënës dhe zelltar i vyer për tërë jetën duke u vënë në shërbim të Jezusit të cilin e luftonte aq bindshëm. Tani, ai do të bëhet vegël e Jezusit siç lexojmë edhe në veprat e apostujve: “*Ai është vegla ime, që unë e kam zgjedhur për ta bërë të njohur Emrin tim para popujve paganë, para mbretërve dhe para bijve të Izraelit*” (Vap 9, 15).

Shën Pali, i quajtur edhe si Apostulli i popujve, pa dyshim është një ndër figurat më të mëdha e më të rëndësishme të krishterimit. Jeta e tij e mëparshme si farise, përndjekës i krishterimit, njohja e Ligjit dhe e botës pagane heliniste dhe romake, pastaj kthimi në krishterim, veprimtaria e tij në mbarë botën e atëhershme pagane, dhe së fundmi martirizimi në Romë, e bëjnë atë vërtet të papërsëritshëm dhe të pakrahasueshëm.¹²

Pali, pas kthimit të tij në Damask¹³, e kupton se mes Jezusit dhe të krishterëve ekzistonte një lidhje shpirtërore, një bashkim sakramental, mister ky dhe themel i qenies sonë – Kishës, e njëkohësisht edhe dashurisë sonë ndaj Saj.¹⁴

Rreth kthimit të tij ka shumë interpretime dhe shpjegime. Disa flasin për vegim, të tjerët për përjetim mistik personal, me të cilin Jezusi i ngjallur iu është zbuluar në thellësi dhe menjëherë ia dhuroi tërësinë e misterit të Ringjalljes.

Papa Benedikti XVI, kthimin e Shën Palit në Damask e quan fryt të takimit personal me Krishtin.¹⁵

⁹ Krh. Heb 9, 22.

¹⁰ Krh. JOSEF HOLZNER, vep. E cit. fq. 32.

¹¹ Vendi ku e përjetoi kthimin e vet Sauli ndodhet pak para mureve të qytetit të Damaskut, ndërsa, sot, ky vend është afër varrezave të të krishterëve.

¹² LUSH GJERGJI, Shën Pali Apostulli i Popujve, Drita, Prizren 2009,

¹³ Krh. Vap 9, 1-18.

¹⁴ Ghidell, vep. E cit. Fq. 18.

¹⁵ Ati i Shenjtë, kur flet për kthimin e Shën Palit, ndër tjera shkruan: “*Lidhur me këtë, kemi dy burime. Më i njohuri, janë rrëfimet që dolën nga penda e Lukës, i cili e tregon tri herë me radhë këtë ngjarje në Veprat e Apostujve (shih 9,1-19;22,3-21;26,4-23). Lexuesi mesatar ndoshta tundohet të ndalet tepër tek disa hollësira, siç është drita nga qielli, rrëzimi përdhe, zëri që thërret, verbimi, shërimi pasi i bie perdja nga sytë e pendesa. Por të gjitha këto hollësira na çojnë në qendër të ngjarjes: Krishti i ngjallur duket si dritë verbuese e i flet Saulit, ia shndërron mendimin e tij e vetë jetën. Shkëlqimi i të Ngjallurit e verbon: duket kështu, edhe nga jashtë, ajo që po ndodhte në shpirtin e tij, verbëria, që e pengonte për të parë të vërtetën, dritën e Krishtit. E pastaj, ‘po-ja’ përfundimtare, të cilën ia tha Krishtit në pagëzim, ia hap rishtas sytë e tij, e bën të shohë.*

Tipin e dytë të burimeve mbi kthimin, e gjejmë tek vetë Letrat e Shën Palit. Ai nuk flet kurrë me hollësira për këtë ngjarje, e unë besoj se e bën këtë nga që mendon se të gjithë i njihnin çastet kryesore të kësaj historie, të gjithë e dinin se nga përsekutues, ai u shndërrua në Apostull të zellshëm të Krishtit. E kjo nuk ishte pasojë e një reflektimi, por e një ngjarjeje të jashtëzakonshme, e takimit me të Ngjallurin” (Shih. Katekeza e VII e Papës

Pas kthimit ai tërhiqet për tri vite në Arabi dhe në një mënyrë aty do të vazhdojë të meditojë mbi krejt atë që i ka ngjarë, por edhe të përgatitet për të filluar më pas të flasë, të dëshmojë fuqishëm për ngjalljen e Krishtit. Pas kësaj periudhe, Pali kthehet duke u predikuar hebrenjve në Damask, pastaj në Jerusalem dhe më vonë në qytetin e lindjes, në Tars, ku do të kaloj një kohë të qetë në pendesë dhe uratë.

Kishte ardhur koha kur Pali do të duhej vërtetë të fillojë misionin e tij, dhe kjo ngjan në takimin me Barnabën. Njëherit kjo ishte koha kur Pali fillon veprën e vet misionare për t'u orientuar më vonë drejt Antiokisë, që ishte qytet me mbi pesëqind mijë banorë. Qyteti i tretë për nga numri i banorëve, pas Romës dhe Aleksandrisë. Antiokia luan rol të rëndësishëm në jetën e Shën Palit. Në këtë qytet ai ballafaqohet me romakët, grekët, sirianët dhe hebrenjtë të cilëve do t'u flasë për Krishtin. Tani Barnaba e nxit Palin me fjalët: “Mësuesi është këtu dhe të thërret”, “*Magister adest et vocat te! Eja me mua në Antioki*”.¹⁶

Barnaba do të jetë bashkëpunëtor i afërt dhe i denjë i Shën Palit në shumë udhëtime të tija. Më vonë, pas kthimit nga Jerusalem, ata do të marrin me vete edhe Markun, të cilin kishin për qëllim ta angazhonin me punë në mesin e paganëve.

Udhëtimet misionare të Shën Palit

Udhëtimi i parë

Sa i përket udhëtimit të parë misionar, Shën Pali e fillon atë në vitin 46-48 dhe për qëllim kishte ungjillëzimin e Qipros dhe të Turqisë. Veprën e madhe misionare Shën Pali e fillon në Antioki, ku gjendej bashkësia më e madhe e të krishterëve të parë.

Ky ishte fillimi i mbarë dhe serioz i përhapjes së Ungjillit. Barnaba, Pali dhe Marku nisen jo për qëllime kulturore apo bamirësie, por vetëm për të predikuar Lajmin e Gëzueshëm. Vendi i parë ishte vendlindja e Barnabës, Qipro,¹⁷ një ujdhesë e pasur dhe menjëherë fillojnë predikimin në sinagogat e qytetit të Salaminës. Pastaj do të vazhdojnë me këtë mision edhe në qytetin Pafo, për të lundruar më tutje drejt Azisë së Vogël, konkretisht në Turqi. Ndër qytetet tjera ku me shumë sukses vepruan Pali dhe Barnaba, duke u predikuar paganëve janë edhe Ikonia, Listra.¹⁸ Do të kalojnë rreth tri vite gjatë këtij udhëtimi misionar, dhe në të gjitha bashkësitë Pali kishte dëshirë dhe angazhohej që në to të zgjidhen njerëz që do ta prijnë bashkësinë në të ardhmen. Edhe pse persekutimi i tyre ishte i vazhdueshëm, dashuria për Krishtin i shtynte të jenë të qëndrueshëm në përhapjen e Ungjillit.¹⁹

Rrugët nëpër të cilat kaloi Pali janë:

Rruga (Via) Appia “*Mbretëresha e rrugëve romake*”, që lidhte Romën me Napolin dhe Brindisin;

Rruga Egnatia që shkonte nga Durrësi për Selanik, Filipe për Neopolis (Bizant);

Rruga Indie që fillonte në Efez dhe kalonte nëpër Magnesia, Tralli, Laodicea, Antiokia, Pisidia, Ikonia, Tarsi;

Rruga Maris që lidhte në mes veti qytetet, si: Troja, Pergamo, Smirnën dhe Efezin, pastaj lëshohej drejt Antiokisë, Palestinës dhe Egjiptit.²⁰

Benediktit XVI “Kthimi” i Shën Palit, në vazhden e mësimëve mbi jetën e tij, mbajtur në Romë në audiencën e përgjithshme, 3 shtator 2008).

¹⁶ J. HOLZNER, vep. E cit. Fq. 89. Shih edhe: YVES IVONIDES, *Pali i Tarsit Vigani i Krishterimit*, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Tiranë 2008, fq. 63.

¹⁷ Krh. Lush GJERGJI, vep. E cit. “Fillimin i predikimit të Shën Palit gjatë udhëtimit të parë e gjejmë në Vap 13-14, ku përmenden Qipro, vendlindja e Barnabës, Galacia, Turqia e sotme qendrore, diku rreth viteve 46-48 duke u predikuar kryesisht hebrenjve, por edhe paganëve”, fq. 29. Në vazhdim mbi udhëtimet e Palit, fq. 30-34.

¹⁸ ANGELO RANON, San Paolo, Vita e Lettere, introduzione al nuovo testamento II, Messaggero, Padova 1991, fq. 53-54.

¹⁹ Pali ishte i vendosur në thirrjen e vet dhe me përkushtim të madh do të kryejë misionin e tij, veçmas duke e gjetur forcën në fjalët e Zotërisë: “*Të kam caktuar të jesh dritë për paganët, që ta çosh shëlbimin deri në skajin e tokës*” (Vap 13, 47).

²⁰ Ibid., fq. 59.

Gjatë predikimeve të tija, Pali nuk flet për Jezusin e Nazaretit, Jezusin e mrekullive, të fjalimeve dhe shembujve, por ai fillon e flet për Krishtin e sotshëm dhe të gjallë, të kryqëzuar e të ringjallur.

Udhëtimi i dytë misionar i Palit

Pas një periudhe jo shumë të gjatë nga përmbyllja e udhëtimit të parë, Pali e fillon udhëtimin e dytë në vitin 49. Kësaj radhe ai do të udhëtojë në Maqedoni dhe Greqi. Periudhat e rëndësishme të këtij udhëtimi janë katër, secila me fizionominë dhe problemet e veta specifike:

- Filipea, qytet romak në të cilin veçohet kthimi në të krishterë i Lidisë dhe lirimi i mrekullueshëm i apostujve nga burgu;
- Selaniku, kryeqyteti Maqedonisë, i cili u ungjillëzua me shumë pengesa nga ana e judenjve;
- Athina, qytetit – nënë e kulturës, e filozofisë dhe artit do t'i kushtohet një vëmendje e veçantë nga Pali;
- Korinti është qyteti në të cilin do të lindë bashkësia më aktive e të krishterëve të Kishës së parë.²¹ Njëherit, aty besimtarët për të parën herë do të quhen të "krishterë". Gjatë gjithë kësaj kohe, Pali jo vetëm që është shumë i angazhuar në predikimet e veta, këtu po veçoj mësimin e tij në Areopag²², por ai gjatë kësaj kohe shkruan shumë me qëllim që të mbështesë bashkësitë e themeluara dhe t'i përforcojë në fe.

Udhëtimi i tretë i Palit

Gjatë viteve 53-58 Pali udhëton për në Efez dhe Korint²³, por gjatë kësaj kohe, bashkë me Timoteun dhe Titin, ai viziton Kishat e themeluara prej tij.

Efezi ishte qytet ku zhvillohej jetë kulturore kur merret parasysh i gjithë arti dhe filozofia që e karakterizonte atë. Veprat e Apostujve sjellin dëshmi të qarta mbi predikimet e Palit në këto anë, dhe jo vetëm të tij, por edhe shumë të tjerë si Apoloni.²⁴ Kjo bënte që apostujt të merrnin zemër në misionin e tyre, sepse dita - ditës shtohesh numri jo vetëm i të pagëzuarve, por përgjithësisht edhe i njerëzve që do t'i ndihmojnë konkretisht në veprën e tyre.

Gjatë këtij udhëtimi Pali e vazhdon mësimin e tij në Maqedoni dhe Ilirik. Më këtë rast Pali do të qëndrojë edhe në Durrës.²⁵

Pali ndjek rrugët kryesore romake, të cilat shërbenin për interesa të ndryshme tregtie e tjera. Ndër to veçohen *Rruga Appia*, që është një nga rrugët më të hershme të çonte nga Roma në Brindisi. Pastaj, *Rruga Egnatia* që ishte një mrekulli e inxhinierisë së lashtë. Sami Frashëri pohon se emri "Egnatia" e ka origjinën nga fjala shqipe "e gjata". Drejtimi i saj është nga lindja, kurse largësia matet me shtylla për çdo milje. E gjithë rruga është 535 milje. Ajo kalon përmes qytetit të Ohrit dhe Pilonit që ndan Ilirikun me Maqedoninë. Vazhdon përmes Manastirit në Edesa e Pela, deri në Selanik.²⁶

Po ashtu, rruga prej Efezi në Korint²⁷, sa i përket misionit të Palit, do të jetë shumë e frytshme, e në anën tjetër, ai vazhdon t'u shkruajë bashkësive, si asaj të Galatasve, ashtu atyre në Korint. Aty do të shkruajë edhe kryeveprën e vet *Letrën drejtuar Romakëve*.

²¹ Ibid., fq. 73.

²² "Atëherë Pali u ngrit në mes të Areopagut e tha: Qytetarë të Athinës! Po shoh se në çdo pikëpamje qenkeni njerëz shumë besimtarë. Sepse, duke kaluar e vërejtur monumentet tuaja të kultit hyjnor, gjeta edhe një lter, në të cilin është shkruar: 'Hyjit të panjohur.' Pra, Atë, të cilin ju e nderoni pa e njohur, unë jua kumtoj" (Vap 17, 22-23).

²³ Krh. Vap 18, 1-12.

²⁴ "Një farë hebreu që quhej Apolon, me prejardhje nga Aleksandria, kishte ardhur në Efes. Ishte njeri gojëmbarë dhe njohës i mirë i Shkrimit të shenjtë" (Vap 18, 24).

²⁵ Zef Mirdita, Krishterimi ndër Shqiptarë, Drita, Prizren-Zagreb 1998, fq. 118-119.

²⁶ EDWIN JACQUES, Shqiptarët, Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, Fondacioni Abraham Lincoln, Kartë e Pendë, Tiranë 2005, fq. 154.

²⁷ Vap 18.

Mësimi i tij

Gjatë gjithë veprimtarisë së tij, Pali ka për qëllim të bëjë sa më shumë njerëz për Jezun Krishtin, duke u predikuar me zell të madh. Përveç kësaj i përforconte nxënësit në qëndresë të fesë, duke i mësuar ata se duhet kaluar nëpër shumë vështirësi për të hyrë në Mbretërinë e Hyjit. Ai dinte t'u përshtatej mjedisit dhe njerëzve duke depërtuar në shpirtin e filozofisë së tyre. Misionariteti i Palit ka ditur të dialogojë me popujt e ndryshëm dhe me kulturat e ndryshme, ka ditur t'u përshtatet personave të ndryshëm dhe mjedisëve të ndryshëm, ka ditur të sajtojë metoda të ndryshme për kërkimin e të vërtetës. Është shumë ndriçues krahasimi i artit orator që Pali përdor në Listër (krh. Vap 14,15-18) e në Athinë (krh. Vap 17,16-31), në një mjedis pagan, me mënyrën e të folurit në një mjedis judaik (krh. Vap 13,16-41): dy mënyra shumë të ndryshme, por përplotësuese për t'iu përgjigjur nevojave të dëgjuesve, për t'i çuar të gjithë së bashku në portin e të vërtetës.²⁸

Për Shën Palin, ngjallja e Jezun Krishtit është epiqendra e mbarë historisë, sepse në Të plotësohen ligji dhe profetët, dhe nga Ai vjen shëlbimi për të gjithë. Në anën tjetër, Shën Pali mëson për dashurinë ndaj të afërmit, si bazë e fesë, pa të cilën asnjë vepër e jona nuk do të kishte kuptim. Këtë fakt Shën Pali e shpreh mrekullisht në Himnin e tij të famshëm kushtuar dashurisë:

“Po t'i flisja gjuhët e njerëzve e të engjëjve, por të mos kisha dashurinë, do të isha pors bronzi që kumbon e pors cimballi që tingëllon, po ta kisha dhuratën e profecisë e t'i dija të gjitha misteret e të gjitha dituritë; po ta kisha edhe fenë e plotë, me të cilën të mund t'u shndërroja vend maleve, por po të më mungonte dashuria, s' do të isha asgjë!”²⁹

Megjithëse ai thotë se nuk është i denjë të quhet apostull³⁰, është vështirë të vlerësohet vepra dhe misioni i tij i madh në shërbim të Krishtit të cilin e predikon.

Pas Jezusit, Shën Pali është personaliteti për të cilin flitet më së shpeshti në Besëlidhjen e Re. I thirrur prej Krishtit të Ringjallur, ai është apostulli i cili në të shumtën e rasteve, i pari e shpalli Krishtin në gjithë hapësirën mesdhetare.³¹ Mbështetja e tij e fuqishme ishte miku i tij Barnaba.³²

Rruga e tij si njeri i ri, apostull i Jezusit, ka filluar të jetësohej fillimisht në Anatoli (Jordania e sotme), e sidomos në Greqi dhe në Azi (Turqinë e sotme). Në shumë raste akuzohet dhe burgoset nga hebrenjtë në Jerusalem, me padi se po shkakton çrregullim të rendit publik. Por, Pali do të thirret në nënshtetësinë romake³³, duke u mbrojtur nga akuzat e pabaza që i bëheshin. Më vonë deportohet në Romë për disa vite, si i burgosur shtëpiak. Por, edhe në këtë gjendje ai do të vazhdojë të mësojë dhe shkruajë për fenë në Krishtin ,të cilit ia kushtoi jetën e vet. Këtë e pohon edhe vetë duke thënë: “*Jetoj, por jo më unë, në mua jeton Krishti*”.³⁴

²⁸ Ghidelli, fq. 59.

²⁹ 1 Kor 13, 1-13 - Himni i dashurisë.

³⁰ Lexojmë në Letrën e Parë Korintianëve: “... unë nuk jam i denjë as të quhem apostull, sepse e kam salvuar Kishën e Hyjit. Por, në saje të hirit të Hyjit, jam ky që jam, dhe hiri i tij në lidhje me mua nuk ka qenë i kotë. Madje u mundova të veprojmë shumë se të gjithë ata, njëmend, jo unë vetëm, por edhe hiri i Hyjit me mua” (15, 9-10).

³¹ Krh. ANGELO RANON, vep. E cit. fq. 6.

³² Krh. Vap, 11, 25-30; 13, 1-25; 14, 1-28. Mbi bashkëpunimin dhe veprimtarinë e Palit dhe Barnabës, krh. edhe: Holzner, vep. E cit. Fq. 89-97.

³³ Krh. Vap 22, 27-29.

³⁴ Gal 2, 20.

Krishterimi në trevat Iliro-shqiptare

Për këtë shenjt, predikatar të palodhshëm dhe dëshmitar të Lajmit të Gëzueshëm, është shkruar shumë dhe nga autorë të ndryshëm. Po ashtu, mbi dëshmitë që lidhen ngushtë me ungjillëzimin e popullit tonë, kanë shkruar edhe egzegetë e historianët tanë.

Pra, siç është e njohur nga burime të ndryshme shkencore, veprimtaria e Shën Palit Apostull, e këtij vigani të krishterimit, lidhet ngushtë me historinë, besimin dhe kulturën tonë shqiptare. Ndër tjera, edhe për këtë arsye e kemi obligim që t'i kushtojmë atij një vëmendje të veçantë. Literatura e përgjithshme, veçmas ajo kishtare, dëshmon për faktin e rëndësishëm se ilirët, paraardhësit tanë, janë ungjillëzuar nga Shën Pali Apostull.

Iliriku ka hyrë në literaturën sakrale pikërisht me këtë Apostull dhe bazë e kësaj janë Letrat e tij. Në Letrën drejtuar Romakëve shkruan: “*Kështu, që prej Jerusalemit e për qark në Iliri e kam përhapur Ungjillin e Krishtit*” (15, 19).³⁵

Në këtë kontekst ndërlihet edhe Letra tjetër e tij, drejtuar Titit në të cilën thuhet: “*Kur ta dërgoj te ti Artemin ose Tihikon, nisu e eja te unë në Nikopol, sepse atje vendosa të kaloj dimrin*” (3, 12). Nikopoli ishte qyteti më i njohur i Epirit, fare pranë Ilirikut, dhe, nga këtu, Pali e dërgon Titin në Dalmaci: “*Nisu dhe eja sa më parë te unë, sepse Dema, për dashuri të këtij shekulli, më la vetëm. Ai shkoi në Selanik, Kreshenci në Galaci, Titi në Dalmaci*” (2 Tim 4, 9- 10).

Megjithëse askund nuk përmendet se Pali arriti vetë në Ilirik, këto dëshmi nga Shkrimi Shenjt na bëjnë të mendojmë bindshëm se Shën Pali është ai që mbolli farën e krishterimit në viset tona.³⁶

Në Letrën e Parë drejtuar Selanikasve shkruan: “*Sepse, prej jush, jo vetëm jehoi Fjala e Zotit nëpër Maqedoni e Akajë, por edhe feja juaj në Hyjin aq fort u përhap gjithkah...*” (1 Sel 1, 8). Përveç kësaj, predikimi i Ungjillit do të vazhdojë të përhapet në Dardani dhe vise tjera Ilire³⁷, duke u mishëruar në botëkuptimet e tyre.

Pali ndoqi besnikërisht rrugët romake dhe përgjatë tyre shtoheshin vazhdimisht bashkësitë e reja të krishtera. Ai udhëtoi përmes rrugës Egnatia që përfshinte rreth 270 km nga Selaniku drejt perëndimit, deri në Shqipëri. Historianë si Farlati, pohojnë se bashkësia e Durrësit ishte më e vjetra në Shqipëri, e themeluar nga Shën Pali Apostull, gjatë predikimeve të tija në Iliri dhe Epir.³⁸

Letrat e Shën Palit

Letrat e Shën Palit dhe veprat e Apostujve janë burimet themelore për të studiuar dhe njohur personalitetin dhe teologjinë e tij. Besëlidhja e Re përmban 14 Letra të Shën Palit të cilat përbëjnë gati ¼ e gjithë kësaj pjesë të Shkrimit Shenjt.

Ato ndahen në katër grupe, si:

Letrat e para - Letra e parë dhe e dytë Selanikasve;

Letrat e mëdha - Romakëve, e para dhe e dyta Korintasve dhe Letra drejtuar Galatasve;

Letrat nga burgu - Kolosianëve, Efesianëve, Filipianëve dhe Letra Filemonit;

Letrat pastorale – E para dhe e dyta Timoteut dhe Titit;

³⁵ Gaspër GJINI, Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj, Drita, Ferizaj 1992, fq. 23. Mbi këtë argument shih edhe: EDWIN JACQUES, vep. E cit. fq. 158-161.

³⁶ Krrh. Zef Mirdita, “Krishterimi ndër Shqiptarë, Simpoziumi Ndërkombëtar, Shkodër 2000, fq. 37. Autori thekson se “*pavarësisht se ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me këtë pyetje, duhet thënë se krishtenizmin në këto treva nuk e sollën as misionarët latinë, as ata grekë, siç është rasti me popujt e Evropës Juglindore, por është i kohës së apostujve dhe dishepujve të tyre*”.

³⁷ Ibid., fq. 41.

³⁸ EDWIN JACQUES, vep. E cit. fq. 154.

Letra drejtuar Hebrenjve i përshkruhet Palit, megjithëse egzegetë të shumtë mendojnë se mund të jetë e ndonjë autori tjetër.³⁹

Në letrat e Shën Palit thirrja dhe dërgimi i tij konsiderohen gjithmonë vepër e Zotit. Ai shkruan: *“Porse, kur Atij, që më zgjodhi qysh në kraharonin e nënës dhe më thirri me hirin e vet, i pëlqeu të zbulojë në mua Birin e vet për ta shpallur ndër paganë.”*⁴⁰

Veçojmë me këtë rast një pjesë nga mësimet e tija ku flet për lirinë me këto fjalë: *“Vërtet, vëllezër, ju jeni të grishur në liri! (Gal 5, 13). Lidhur me këtë, një ipeshkëv italian, Ghidelli, shpjegon më tutje: “Liria, dashuria dhe e vërteta janë si tri motra të pandashme: nëse rrinë së bashku, atëherë janë si tri energji jetësore, që na ndihmojmë të jetojmë mirë; në rast të kundërt zhduken të gjitha së bashku dhe ne mbetemi pa atë që është e domosdoshme për të bërë një jetë të hijshme të krishterë. E vërteta, dashuria dhe liria: dy të parat shprehin vlera absolute, ndërsa e treta vihet në shërbim të tyre. Mund të themi se liria na është dhënë për të arritur në të vërtetën dhe për të jetuar në dashurinë. Vetëm me këto kushte liria e realizon në plotësi natyrën e vet: “Vërtet, vëllezër, ju jeni të grishur në liri! Por, kini kujdes që kjo liri të mos bëhet shkak të jetoni si do trupit, por - me dashuri shërbejini njëri-tjetrit!” (Gal 5,13)*⁴¹

Në të gjitha Letrat e Palit, që janë pasqyrimi letrar i zërit të tij të gjallë, mund të vërehet shërbimi i tij me përkushtim.

Mësimi që jep Pali, e që vërehet në të gjitha Letrat e tij, ka të përbashkët shpjegimin dhe dëshminë bindëse të fesë në Jezu Krishtin, sidomos në veprën e shëlbimit për të gjithë njerëzit.

Udhëtimi i Palit për në Romë

Veprat e Apostujve e përshkruajnë këtë udhëtim të tij në 2 kapitujt e fundit.⁴² Pali i cili kishte kërkuar të gjykohej para perandorit si nënshtetas romak⁴³, do të arrijë në Romë edhe me qëllimin tjetër që kishte: të predikojë për Krishtin edhe në zemrën e botës pagane. Gjatë udhëtimit, Pali, si i burgosur, ballafaqohet me vështirësi të ndryshme, stuhia e detit gjatë së cilës anija thyhet, pastaj qëndrimi në Maltë, dhe nisja për Romë pas tre muajsh.

Kur arrin në Romë, Pali qytetar romak, fiton lejen të ketë banesën e vet të veçantë, por me një ushtar që e ruante.⁴⁴ Kështu, për dy vjet rresht, Pali vazhdoi predikimin e vet, dhe përpos kësaj, ai shkroi Letrat e njohura nga burgu: Atë drejtuar Kolosianëve, Efesianëve dhe Filemonit.

Martirizimi i tij

Shën Pali në Letrën që ua kishte drejtuar Romakëve kishte shkruar: *“... Ungjilli është fuqia e Hyjit për shëlbimin e atij që beson: më së pari për judeun e pastaj për grekun. E njëmend në të zbulohet drejtësia e Hyjit me anë të fesë e për fenë, siç është në Shkrimin e shenjtë: “I drejti do të jetojë prej fesë” (Rom 1, 16-17). Kështu edhe tani, fjalët e fundit të Palit nuk janë fundi, dëshpërimi apo vdekja, por përkundrazi, ngadhënjimi, përhapja dhe zhvillimi i krishterimit dhe Lajmit të Gëzueshëm edhe në Perandorinë Romake.*

Tani, Pali personalisht është i gatshëm të vdesë sikur e dëshmon edhe në Letrën e Dytë drejtuar Timoteut: *“Sa për mua – gjaku im tashmë po derdhet në nder të Hyjit dhe koha të*

³⁹ ANGELO RANON, vep. E cit. fq. 14.

⁴⁰Krh. Gal 1, 15.

⁴¹ Krh. CARLO GHIDELLI, vep. E cit. fq. 52.

⁴² Vap, 27. 28.

⁴³ Vap 22, 26-29 “Kur centurioni e dëgjoi, iu afrua tribunit e i tha: “Çka mendon të bësh? Ky njeri është romak!” Tribuni iu afrua dhe i tha: “Më thuaj, a je ti romak? “Po!” - iu përgjigj Pali. “Unë - tha tribuni - e kam blerë shtrenjtë këtë nënshtetësi.” Pali iu përgjigj: “Unë kam lindur me të!” Prandaj, me të shpejtë u larguan prej tij ata që do ta merrnin në pyetje. Po edhe tribunit i hyri frika, kur e mori vesh se ishte nënshtetas romak e ky e kishte lidhur në hekura”.

⁴⁴ Vap 28, 16.

nisem për atë jetë arriti! Luftën e mirë e luftova, vrapimin e kreve, fenë e ruajta. Që tani më pret gati kurora e drejtësisë, që atë Ditë do të ma japë Zoti, Gjykatësi i drejtë; dhe jo vetëm mua, por të gjithë atyre që do ta presin me dashuri Ardhjen e tij ” (2 Tim 4, 6-8).

Dhe në fund kështu ndodhi. Martirizimi i Shën Palit, qytetarit romak, ndodhi rreth vitit 67. Duke iu nënshtruar ligjit, Shën Pali nisesh rrugës për të mos u kthyer më. Romakët praktikonin që të dënuarit t'i nxirrnin jashtë mureve të qytetit. Kështu edhe atë e dërguan rreth 3 km e gjysmë drejt vendit të quajtur Ostiense. Nga aty kthyen për te *Aquae salviae* (Tri burimet) ku u ekzekutua dënimi.

Vdekjen e vet Pali e mban si flije të cilën ia paraqet Zotit për të mirën e vëllezërve, sikur bëri me jetën që ia kushtoi Krishtit.

Përshkrimin e plotë të martirizimit të Shën Palit e gjejmë në “Veprat e Palit” të shkruara ka fundi i shek. II. Në to thuhet se ishte Neroni ai që e dënoi Palin me prerjen e kokës.

“Apostulli vdiq, shkruan Papa Benedikti XVI, por mësimet e tij mbeten të pavdekshme, siç e dëshmon ndikimi i menjëhershëm që patën Letrat e Palit mbi bashkësinë e parë të krishterë. Ato u bënë menjëherë ushqim shpirtëror për besimtarët e të gjitha kohëve.”⁴⁵ Trupin e tij e varrosën jo larg prej vendit të ekzekutimit, në një hapësirë pagane që ishte pronësi e një gruaje të krishterë me emrin Lucina. Sot në të njëjtin vend qëndron në madhështinë e saj, Bazilika e Shën Palit jashtë Mureve.”⁴⁶

Varri i Shën Palit, menjëherë do të bëhet vend shtegtimi i të krishterëve të parë, të cilët edhe pse nën persekutim të vazhdueshëm, bashkohen te varri i tij në lutje që ta çojnë përpara veprën e këtij misionari të madh të popujve.

Shtrojmë pyetjen prej nga vjen kjo fuqi, ky zell e përkushtim i Palit në misionin e tij, pas gjithë asaj përvoje të hidhur që kishte pasur me të krishterët e parë, të cilët edhe i persekutoi?! Përgjigja është: nga e Vërteta e Amshuar – Jezu Krishti, të cilin as ilirët, as paganët tjerë ende nuk e kishin njohur, ndërsa tani, pas kthimit, Pali ua predikon dhe i bën të ballafaqohen dhe ta pranojnë këtë mësim të ri.

Shën Pali, i nisur nga fuqia e kësaj së Vërtete, shtegtoi në shumë vende pagane e jo pagane, që të mbillte farën e shpëtimit, të dhuronte atë që vetë e kishte pranuar si dhuratë. Aty ku shkoi, mbolli me sukses të madh mësimin e Krishtit, dhe rezultatet e kësaj pune i gëzojnë sot shumë popuj, në mesin e të cilëve jemi edhe ne shqiptarët, ndër popujt e parë të Ballkanit që patën fatin ta kenë këtë apostull të madh, atin e krishterimit. Prandaj, me të drejtë shprehet mburrje e madhe se pikërisht ky apostull ka mbjellë identitetin e krishterë edhe ndër ne.

Po përfundoj me urimin që viti jubilar kushtuar Shën Palit, të jetë kohë kur do të angazhohemi me të gjitha energjitë shpirtërore për këtë krenim të caktuar nga Ati i Shenjtë, Papa Benedikti XVI, ndërsa, Shën Pali ia besojmë shenjtërimin tonë personal, duke lutur ndërmjetësinë e tij për mbarë popullin tonë.

45 Krh. Audienca e përgjithshme e Papës Benediktit XVI, që kishte për temë martirizimin e Shën Palit, Romë 04 shkurt 2009.

⁴⁶ Krh. HOLZNER, *vep. E cit. Fq. 520*. Kjo kishë gjendet jashtë mureve të qytetit të Romës, prandaj edhe quhet me këtë emër. Në mesjetë kur nga popujt të ndryshëm pushtohet Roma, të krishterët për të mbrojtur nga sakrilegjet e mundshme të këtyre barbarëve, e bartin kokën e tij brenda qytetit në kishën e Shën Gjon Lateranit. Edhe armiqët edhe tërmetet disa herë e kanë dëmtuar këtë kishë, por fatkeqësisht, në natën në mes 15 dhe 16 korrikut të vitit 1823 nga zjarri do të shkatërrohet kjo Bazilikë. Edhe me këtë rast shpëton varri i tij. Papa Luani XII do të angazhohet rreth ndërtimit të saj duke e ftuar mbarë botën e krishterë të ndihmojnë me ofertat e tyre për këtë projekt. Kështu, në vitin 1854 kjo Bazilikë do të shugurohet nga Papa Piu IX. Bazilika është e gjatë 120 m, e gjerë 60 ndërsa e lart 23 metra (Mbi përshkrimin e Bazilikës shih: R. Wimer, *vep. E cit. Fq. 308*, si dhe web. faqen www.annapaolino.org

Literatura e përdorur:

Josef HOLZNER, *Pavao*, Verbum, Split 2008.

Angelo RANON, *San Paolo, Vita e Lettere, introduzione al nuovo testamento II*, Messaggero, Padova 1991.

Rudolf VIMER, *Život Svetoga Pavla*, UPT, Đakovo 2005.

Yves IVONIDES, *Pali i Tarsit Vigani i Krishterimit*, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Tiranë 2008.

Lush GJERGJI, *Shën Pali Apostulli i Popujve*, Drita, Prizren 2009.

Carlo GHIDELLI, *Një vit me Shën Palin*, Drita, Prizren 2009.

Edwin JACQUES, *Shqiptarët, Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Fondacioni Abraham lincoln, Kartë e Pendë, Tiranë 2005.

Zef MIRDITA, *Krishterimi ndër shqiptarë*, Drita-MKSH, Prizren-Zagreb 1998.

Gaspër GJINI, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, Drita, Ferizaj 1992.

Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë, Simpoziumi Ndërkombëtar, “*Krishterimi ndër shqiptarë*”, Shkodër 2000.